

FEDRATA E SHENJËTARËVE TË KOSOVËS

RREGULLORJA

MBI ORGANIZIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDRATËS SË
SHENJËTARISË TË KOSOVËS NË PRISHTINË

Prishtine, 27 janar 2007

Në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2005 për Regjistrimin dhe licencimin e Federatave dhe Shoqërive sportive, nenit 23 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë të Kosovës, Kuvendi i FSHK-së në mledhjen e vetë të mbajtur më 27.01.2007, aprovoi

RREGULLORËN

MBI ORGANIZIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË TË KOSOVËS NË PRISHTINË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1 Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Kuvendit të Federatës së Shenjëtarisë të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi i FSHK-së).

Neni 2

1.1 Kuvendin i FSHK-së e përbëjnë nga dy (2) përfaqësues të anëtarëve të autorizuar (Klubeve) dhe nga një (1) përfaqësues të TMK-së, SHPK-së dhe PAK, për për periudhë kohore prej 4 viteve.

Neni 3

- 3.1 Puna e Kuvendit të Federatës realizohet në mbledhjet e rregullta dhe zgjedhore.
- 3.2 Mbledhjet e rregullta të Federatës mbahen një herë në vit, sipas rregullit në fillim të çdo viti kalendarik.
- 3.3 Mbledhjet zgjedhore të Federatës mbahen në çdo katër (4) vite dhe atë më se voni 30 ditë pas skadimit të mandatit anëtarëve të Kuvendit.

II. PËRGADITJA DHE THIRRJA PËR MBLEDHJE TË KUVENDIT

Neni 4

1.1 Thirrja për mbledhjen e Kuvendit të Federatës me propozimin e rendit të ditës dhe materialin gjegjë, iu dërgohet anëtarëve të Kuvendit më se voni 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Neni 5

- 5.1 Mbledhja e Kuvendit të Federatës mund të mbahet nëqoftëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Kuvendit të Federatës.
- 5.2 Në rast se vërtetohet se në mbledhje nuk marrin pjesë numri i duhur i anëtarëve, mbledhja e Kuvendit shtyhet dhe e njëjta thirret në afatin prej 10 ditëve.

III. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJET E KUVENDIT

Neni 6

- 6.1 Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Federatës i udhëheqë Kryetari i Federatës, ose në mungesë të tij personi të cilin ai e cakton.
- 6.2 Mbledhjet zgjedhore të Kuvendit të Federatës i udhëheqë Kryesia e punës, e cila zgjedhet në mbledhjen e Kuvendit të Federatës.
- 6.3 Kryesinë e punës e propozon dhe të njëjtën e udhëheqë Kryetari i Federatës i përbërjes së gjërtanishme, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Neni 7

- 7.1 Para fillimit të mbledhjes, Kryetari vërteton numrin e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent dhe që mungojnë dhe njofton të pranishmit se në mbledhje prezentojnë numër i duhur i anëtarëve për marrjen e vendimeve të plotëfuqishme.

Neni 8

- 1.1 Në mbledhjen zgjedhore të Federatës para caktimit të rendit të ditës, zgjedhet Kryesia e punës, Komisioni për verifikimin e anëtarëve të Kuvendit, Komisioni kandidues dhe procesmbajtësi me verifikues të tij.

Neni 9

- 9.1 Në mbledhjen zgjedhore të Federatës, përveç anëtarëve të rinj të zgjedhur të Kuvendit, marrin pjesë me të drejtë vote edhe anëtarët e mëparshëm të Këshillit drejtues dhe mbikëqyrës të Federatës.

Neni 10

- 10.1 Kryetari i Federatës, në pajtim me rendin e ditës të propozuar në thirrjen për mbledhjen e Kuvendit, e hapë diskutimin për rendin e ditës. Pas mbarimit të diskutimit e shpall rendin e ditës.

Neni 11

- 11.1 Anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, të kërkojnë skjarime, të shtrojnë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje.

Neni 12

- 12.1 Shqyrtimi mbi pikat e veçanta të rendit të ditës udhëheqet sipas rregullit, së pari në parim, e pastaj në veçanti, gjegjësisht sipas pjesëve.
- 12.2 Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon Kryetari. Kryetari mund të

propozojë që koha e shqyrtimit të shkurtohet.

Neni 13

- 13.1 Nëse është e nevojshme që mbi disa çështje të veçanta të shqyrtohen dhe të vendoset, atëherë duhet të bëhet skjarimi hyrës. Kryetari i FSHK-së do të caktojë raportuesin, i cili në pika të shkurtëra do të paraqesë pjesën hyrëse dhe do të japë arësytimet.
- 13.2 Kryetari mund që gjatë shqyrtimit të kërkojë që raportuesi ose përpunuesi i materialit, të japë skjarime plotësuese.

Neni 14

- 14.1 Anëtarët e Kuvendit të FSHK-së, gjegjësisht personat tjerë, të cilët janë të thirrur në mbledhje, marrin pjesë në diskutime sipas rendit të paraqitur.
- 14.2 Kryetari mund t'i japë fjalën pa rend raportuesit apo personit tjetër të thirrur, kur e vlerëson të nevojshme për skjarime plotësuese, apo për plotësimin e propozimit për të cilin diskutohet.

Neni 15.

- 15.1 Askush nuk mund të merr pjesë në diskutim para se t'ia jap fjalën Kryetari, të ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësist në diskutim, apo ndonjë mënyrë tjetër të pengojë punën e Kuvendit.
- 15.2 Kryetari ka të drejtë që personi i cili e pengonë punën normale të mbledhjes, t'i japë vërejtje, t'ia marrë fjalën, e në raste të prishjes së rendit të ditës, t'a largojë nga mbledhja.

Neni 16

- 16.1 Diskutimi sipas pikave të rendit të ditës, sipas rregullës zgjatë deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.
- 16.2 Kryetari mbyllë diskutimin dhe propozonë që të kalohet në vendosje.
- 16.3 Në bazë të propozimeve dhe mendimeve të paraqitura në diskutime dhe propozimeve në material, Kryetari apo raportuesi i formulonë rezymet apo vendimet dhe të njëjtat i paraqet në votim.

Neni 17

- 17.1 Mbi propozimet vendoset me votim, i cili mund të jet i hapur apo i fshehtë, mbi të cilën mënyrë vendosë Kuvendi i FSHK-së
- 17.2 Votimi i hapt bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim.
- 17.3 Votimi i fshehtë bëhet me fletëza. Rezultatet e votimit të fshehtë i vërtetonë Komisioni i veçant, të cilin e formonë Kuvendi i FSHK-së me vendimin kur caktohet që votimi të bëhet i fshehtë.
- 17.4 Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e

anëtarëve prezent.

IV. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË FSHK-së

Neni 18

18.1 Në mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të FSHK-së, verifikohet mandati dhe zgjedhën organet:

- 18.1.1 - Kryetari i FSHK-së,
- 18.1.2 – Këshilli drejtues dhe
- 18.1.3 – Këshilli mbikëqyrës,
- 18.1.4 – Gjyqit të nderit, dhe
- 18.1.5 – Arbitrazhi.

Neni 19

19.1 Verifikimin e mandatit të posazgjedhurve e vërtetonë Kuvendi në bazë të raportit të Komisionit verifikues.

19.2 Komisioni verifikues përbëhet prej 3 anëtarëve të zgjedhur në Kuvend.

Neni 20

20.1 Kryetarin e FSHK-së e zgjedhë Kuvendi në bazë të propozimit të Këshillit drejtues në bazë të dispozitave të Statutit.

20.2 Dy të tretat të anëtarëve të Këshillin drejtues i zgjedh në propozim të anëtarëve Kuvendi, kurse një të tretën e anëtarëve të Këshillit drejtues i emronë Kryetari i FSHK-së.

20.3 Këshillin mbikëqyrës, Gjyqin e nderit dhe Arbitrazhin i zgjedh Kuvendi në bazë të propozimeve të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 21

21.1 Komisionet e nevojshme për kryerjen e punëve të caktuara i zgjedhë Këshilli drejtues i posazgjedhur në mbledhjet e veta pas Kuvendit.

V. PROCESVERBALET

Neni 22

22.1 Mbi punën e Kuvendit të FSHK-së, në mbledhje udhëheqet procesverbali.

22.2 Procesmbajtësin e cakton Kryetari me rastin e zgjedhjes së organeve për punën e Kuvendit.

Neni 23

- 23.1 Procesverbali mbi punën e Kuvendit përmbanë të dhënat themelore, dhe këtë:
- 23.1.1 – ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes,
 - 23.1.2 – shenjen dhe numrin e mbledhjes,
 - 23.1.3 – numrin e anëtarëve të Kuvendit prezent dhe joprezent,
 - 23.1.4 – personat tjerë prezent,
 - 23.1.5 – emrin e Kryetarit dhe emrin e procesmbajtësit,
 - 23.1.6 – rendin e ditës,
 - 23.1.7 – emrat e pjesëmarrësve në diskutime me përmbatje të shkurtër të diskutimeve,
 - 23.1.8 – rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës,
 - 23.1.9 – mendimet e ndara të anëtarëve në Kuvend dhe çështjet tjera me rëndësi.
- 23.2 Në fund të çdo pike të rendit të ditës shenohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e ka paraqitur Kryetari.

Neni 24

- 24.1 Procesverbali përpunohet në origjinal dhe në numër të mjaftueshëm të përshkrimit. Procesverbalin origjinal e nënshkruan Kryetari dhe procesmbajtësi dhe i njëjti me materialin tjetër ruhet në arkivin e FSHK-së.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

- 25.1 Çështjet të cilat nuk janë përfshir me këtë Rregullore, rregullohen me vendime të veçanta, të cilat i bie Kuvendi i FSHK-së.

Neni 26

- 26.1 Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe zbatohet në Kuvendin, në të cilin është aprovuar

Neni 27

- 27.1 Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, pushon të vlejë rregullorja nga Kuvendi i Kaluar i FSHK.së.

Prishtinë, 27 janar 2007

KRYETARI I
KUVENDIT TË FSHK-së,
Ali Pllana, e cc dipl.

FEDERATA E SHENJËTARISË E KOSOVËS

RREGULLORJA

MBI PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË
TË KOSOVËS NË PRISHTINË

Prishtinë, 19 Janar 2007

Në bazë të nenit 5 të Udhëzimit administrativ për regjistrimin dhe e Federatave dhe Shoqërive sportive, nenit 23 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë të Kosovës, Këshilli drejtues i FSHK-së, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 19.01.2007, aprovoi

RREGULLORËN

MBI PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË FEDERATËS SË SHENJËTARISË TË KOSOVËS NË PRISHTINË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1 Me këtë Rregullore më afër përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Këshillit drejtues të Federatës së Shenjëtarisë të Kosovës në Prishtinë,(në tekstin e mëtejme:Këshilli drejtues).

Neni 2

- 2.1 Këshillin drejtues e përbëjnë anëtarët e zgjedhur në Kuvendin zgjedhor të Federatës të bazuar në dispozitat statutare, në periudhë kohore prej 4 viteve.

Neni 3

- 3.1 Puna e Këshillit drejtues realizohet në mbledhjet punese, të cilat mund të thirren dhe mbahen sipas nevojës e sëpaku 4 herë në vit.

II. PËRGADITJA DHE THIRRJA E MLEDHJEVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 4

- 4.1 Thirrja për mbledhjen e Këshillit drejtues me propozimin e rendit të ditës dhe materialin për mbledhje, u dërgohet anëtarëve 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
- 4.2 Për çështje urgjente, mbledhja mund të mbahet edhe në ditën e thirrjes pa ftesë dhe rend dite.

Neni 5

- 5.1 Mbledhja e Këshillit drejtues mund të mbahet nëqoftëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se ½ e anëtarëve të Këshillit drejtues.

- 5.2 Në rastet e mungesës së numrit të duhur të anëtarëve të Këshillit drejtues, mbledhja shtyhet dhe caktohet terimini tjetër i mbledhjes për deri sa nuk sigurohet shumica e anëtarëve.

III. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE

Neni 6

- 6.1 Mbledhjet e Këshillit drejtues sipas Statutit i thërret dhe i udhëheqë Kryetari, ose në mungesë të tij njeri nga anëtarët, të cilin e caktonë ai.

Neni 7

- 7.1 Para fillimit të mbledhjes, Kryetari vërteton numrin e anëtarëve që janë prezent dhe të atyre që mungojnë dhe i njoftonë të pranishmit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se mund të mirren vendime fuqiptotë.

Neni 8

- 8.1 Në mbledhjen e parë të Këshillit drejtues, bëhet konstituimi dhe zgjedhen organet e përhershme të Këshillit drejtues.

Neni 9

- 9.1 Kryetari i Këshillit drejtues, e hapë mbledhjen dhe i pyet të pranishmit a pajtohen me rendin e ditës të propozuar dhe e hapë diskutimin. Në bazë të diskutimeve caktohet rendi i ditës dhe fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës.

Neni 10

- 10.1 Anëtarët e Këshillit drejtues marrin pjesë në diskutime për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë spjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.

Neni 11

- 11.1 Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës udhëheqet veç e veç, sipas rregullit së pari në parim e pastaj në veçanti.
11.2 Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryetari. Kryetari mund të propozojë që koha e shqyrtimit të kufizohet.

Neni 12

- 12.1 Askush nuk mund të marrë pjesë në diskutim para se t'ia japë fjalën

Kryetari, të ndërhyjnë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë tjetër të pengojë punën e mbledhjes.

- 12.2 Kryetari ka të drejtë që personit, i cili pengon punën normale të mbledhjes, ti japë vërejtje, t'ia marrë fjalën e në rast të prishjes së rendit të ditës t'a largojë nga mbledhja.

Neni 13

- 13.1 Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.
 13.2 Kryetari mbyllë diskutimin dhe propozonë që të kalohet në vendosje.
 13.3 Në bazë të propozimeve në material, mendimeve të paraqitura gjatë diskutimeve, kryetari formulon rezymetë, apo vendimet dhe të njejtat i paraqet në votim.

Neni 14

- 14.1 Mbi propozimet e vendimeve vendoset me votime të hapta, i cili bëhe me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numrim.
 14.2 Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve prezent.

IV. ZGJEDHJA - KOOPTIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 15

- 15.1 Nëse për çfarëdo arsye numri i anëtarëve të Këshillit drejtues zvoglohet për 1/3, Këshilli drejtues do të bëjë plotësimin me anëtarë të rinjë.
 15.2 Anëtarët e zgjedhur – kooptuar nga Këshilli drejtues i kanë të drejtat dhe obligimet e njëta si dhe anëtarët e zgjedhur në Kuvendin zgjedhor të FSHK-së.
 15.3 Mandati i anëtarëve të rinjë zgjatë aqë sa ka mbetur i pakryer mandati i anëtarit të Këshillit drejtues.

V. KOMPETENCAT E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 16

- 16.1 Këshilli drejtues kryen sidomos këto punë:
 16.1.1 Zbaton vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit,
 16.1.2 Pregaditë materialet për mbledhjet e Kuvendit,
 16.1.3 Pregaditë propozimet e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit dhe të akteve tjera normative për Kuvend,
 16.1.4 I raporton Kuvendit mbi punën e vetë,
 16.1.5 Përcjell Programin dhe kalendarin e garave dhe i organizonë ato në nivel të Kosovës dhe ndërkombëtar,

- 16.1.6 Vendosë për pranimin dhe pushimin e anëtarëve të FSHK-së,
- 16.1.7 Koordinon punën me instirucionet shtetërore, organet dhe organizatat tjera,
- 16.1.8 Zgjedh këshillat dhe komisionet e veta,
- 16.1.9 Pregaditë Projektet dhe i raportonë Departamentit të sportit mbi gjendjen financiare,
- 16.1.10 Organizonë seminare për trajnimin e referëve dhe të trajnerëve,
- 16.1.11 Kujdeset për reprezentacionin e Kosovës,
- 16.1.12 Komunikonë me Federatën Ndërkombëtare të Sportit të Shenjëtarisë dhe me Konfederatën Europiane të Shenjëtarisë,
- 16.1.13 Ndanë trofe, mirënjohje dhe shpërblime,
- 16.1.14 Aprovonë vendime për anëtarësim të FSHK-së në organizmat tjera të vendit dhe ndërkombëtar,
- 16.1.15 Pregaditë Planin vjetor financiar dhe Raportet vjetore,
- 16.1.16 I propozonë Kuvendit për anëtar të nderit,
- 16.1.17 Kryen edhe punë tjera nga kompetenca e vetë.

VI. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 17

- 16.1 Në mbledhjen e parë të Këshillit drejtues bëhet verifikimi i mandatit të anëtarëve në 4 vite dhe në 2 vite dhe zgjedhet:
- Komisioni profesional,
 - Komisioni statutar,
 - Komisioni disiplinor,
 - Komisioni për marrëdhënje me jasht,
 - Komisioni i referëve,
 - Komisionit për marketing, etj.
- Sipas nevojës, Këshilli drejtues formonë edhe komisione dhe trupa tjerë punues, mandati i të cilëve zgjatë deri në kryerjen e detyrës për të cilën janë formuar.

VI. PROCESVERBALET

Neni 18

- 17.1 Mbi punën e Këshillit drejtues, në mbledhje udhëheqet procesverbali.
- 17.2 Procesverbalin, sipas rregullës e udhëheqë Sekretari, ose personi të cili e cakton Kryetari në fillim të mbledhjes.

Neni 19

- 18.1 Procesverbali mbi punën e Këshillit drejtues përmbanë të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjë dh numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve prezent të KD dhe jo prezent, personat tjerë që prezentojnë, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendi i përcaktuar i ditës, emrat e paraqitësve dhe

pjesëmarrsëve në diskutim me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, mendimet e ndara të anëtarëve të KD dhe të çështjeve tjera me rëndësi.

18.2 Në fund të çdo pike të rendit të ditës shenohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet Kryetari.

Neni 20

19.1 Procesverbali përpunohet në origjinal dhe numër të mjaftuar.

19.2 Procesverbali origjinal nënshkruhet nga kryetari dhe procesmbajtësi dhe i njejtë ruhet me materialin tjetër të mbledhjes dhe ruhet në arkiv.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 21

20.1 Çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me vendime të veçanta të Këshillit drejtues.

Neni 21

21.1 Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe zbatohet nga dita në të cilën është aprovuar.

Neni 22

22.1 Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, pushonë të vlejë Rregullorja e deritashme e Këshillit drejtues

Prishtinë, 19.01.2007

KRYETARI I
KËSHILLI DREJTUES,
Ali Pllana, e cc dipl.